

VENDIM
Nr. 65, datë 22.7.2014

**PËR LARGIMIN E Z. RONALD MARX SI ADMINISTRATOR I OPERATORIT TË
SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE SHA (ISH-“CEZ SHPËRNDARJE” SHA) GJATË
KOHËZGJATJES SË ADMINISTRIMIT TË PËRKOHSHËM**

Në mbështetje të ligjin nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike” (i ndryshuar), nenet 3 , 8 dhe 9, vendimit të Bordit të Komisionerëve nr. 5, datë 21.1.2013, “Për vendosjen e shoqërisë “CEZ Shpërndarje” sh.a. në administrim të përkohshëm dhe emërimin e administratorit të shoqërisë “CEZ Shpërndarje” sh.a. në zbatim të vendimit nr. 4, datë 21.1.2013, “Për heqjen e licencave për aktivitetin e shpërndarjes së energjisë elektrike dhe aktivitetit të furnizimit me energji elektrike të shoqërisë Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a. shkresës me nr. 4335/2 prot., datë 17.7.2014, të Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë, Bordi i Komisionerëve të ERE-s në mbledhjen e tij të datës 22.7.2014, pasi shqyrtoi dhe relacionin e drejtorive teknike,

konstatoi se:

- Në datën 23 qershor 2014 është nënshkruar Marrëveshja e Mirëkuptimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe shoqërisë CEZ a.s., për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së krijuar;

- Në datën 16 korrik 2013, nga ana e shoqërisë “CEZ” a.s. dhe me shkresën nr. 4335/2, datë 17.7.2013 të Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë, është kërkuar që me qëllim zgjidhjen e problematikave për përfaqësimin e shoqërisë me palët e treta të ndërmerren të gjitha masat e nevojshme përfshirë veprimet që lidhen me të dhënat e shoqërisë në regjistrat tregtare në Shqipëri.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve

VENDOSI:

1. Largimin e z. Ronald Marx si administrator i Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a. (ish-“CEZ Shpërndarje” sh.a.) për gjatë kohëzgjatjes së administrimit të përkohshëm.

2. Depozitim dhe regjistrimin e këtij vendimi në të dhënat e shoqërisë Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a. me nr. NIPT. K72410014H në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

3. Autorizimin e administratorit të përkohshëm të shoqërisë Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a. për regjistrimin e këtij vendimi.

4. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe të Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë Operatorin e Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a., për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti